15	80	EP Kastriot - Sllovë	Lugji i Ftohtë	28/b	Inproduktive	5.00	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
16	81	EP Kastriot - Sllovë	Lugji i Zojës	29	Pyll	14.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
17	82	EP Kastriot - Sllovë	Lugji i Zojës	30/a	Pyll	5.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
18	83	EP Kastriot - Sllovë	Lugji i Zojës	30/b	Pyll	50.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
19	84	EP Kastriot - Sllovë	Lugji i Zojës	30/c	Kullotë	1.00	Kullotë	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
20	85	EP Kastriot - Sllovë	Bocgjec	31/a	Pyll	6.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
21	86	EP Kastriot - Sllovë	Bocgjec	31/b	Inproduktive	2.50	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
22	87	EP Kastriot - Sllovë	Kodra e Elbi Varnit	32/a	Pyll	6.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
23	88	EP Kastriot - Sllovë	Kodra e Elbi Varnit	32/b	Inproduktive	12.00	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	

24	89	EP Kastriot - Sllovë	Koria e Rodes	33/a	Pyll	9.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
25	90	EP Kastriot - Sllovë	Koria e Rodes	33/b	Inproduktive	3.25	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
26	91	EP Kastriot - Sllovë	Lugu i Ferrave	34/a	Pyll	9.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
27	92	EP Kastriot - Sllovë	Lugu i Ferrave	34/b	Inproduktive	3.75	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
28	93	EP Kastriot - Sllovë	Lugu i Ferrave	35/a	Pyll	7.75	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
29	94	EP Kastriot - Sllovë	Lugu i Kures	35/b	Inproduktive	13.50	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
30	95	EP Kastriot - Sllovë	Koria Derboqit	36	Pyll	8.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
31	96	EP Kastriot - Sllovë	Biçaj	19/c	Inproduktive	14.25	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
32	97	EP Kastriot - Sllovë	Ahu i Kuq	20/a	Pyll	17.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
33	98	EP Kastriot - Sllovë	Ahu i Kuq	20/b	Inproduktive	27.75	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
34	99	EP Kastriot - Sllovë	Molla e Thartë	21/a	Pyll	22.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
35	100	EP Kastriot - Sllovë	Molla e Thartë	21/b	Inproduktive	3.25	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
36	101	EP Kastriot - Sllovë	Molla e Thartë	22/a	Pyll	3.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
37	102	EP Kastriot - Sllovë	Molla e Thartë	22/b	Inproduktive	12.25	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
38	103	EP Kastriot - Sllovë	Kodra e Kuqe	23	Pyll	21.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
39	104	EP Kastriot - Sllovë	Livadhi i Toles	24/a	Pyll	18.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
40	105	EP Kastriot - Sllovë	Kodra e ujkut	24/b	Pyll	18.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
41	106	EP Kastriot - Sllovë	Kodra e Ujkut	25/b	Inproduktive	19.75	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
42	107	EP Kastriot - Sllovë	Lugu i Ftohtë	26/a	Pyll	12.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
43	108	EP Kastriot - Sllovë	Lugu i Ftohtë	26/b	Inproduktive	2.50	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
44	109	EP Kastriot - Sllovë	Lugu i Ftohtë	27/a	Pyll	8.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
45	110	EP Kastriot - Sllovë	Lugu i Ftohtë	27/b	Inproduktive	4.25	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
46	111	EP Kastriot - Sllovë	Lugu i Ftohtë	28/a	Pyll	13.25	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
47	112	EP Kastriot - Sllovë	Përroi i Bralicës	12/a	Pyll	9.50	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
48	113	EP Kastriot - Sllovë	Shpati Ceren	13/a	Inproduktive	19.50	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
49	114	EP Kastriot - Sllovë	Shpati Ceren	13/b	Inproduktive	12.50	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
50	115	EP Kastriot - Sllovë	Tejse	14	Pyll	43.00	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
51	116	EP Kastriot - Sllovë	Tejse	15/a	Pyll	35.50	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
52	117	EP Kastriot - Sllovë	Tejse	15/c	Inproduktive	14.50	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
53	118	EP Kastriot - Sllovë	Stjerdok	16/a	Pyll	22.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
54	119	EP Kastriot - Sllovë	Stjerdok	16/b	Kullotë	18.75	Kullotë	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
55	120	EP Kastriot - Sllovë	Stjerdok	17/a	Pyll	0.20	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
56	121	EP Kastriot - Sllovë	Stjerdok	17/b	Kullotë	20.25	Kullotë	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
57	122	EP Kastriot - Sllovë	Stjerdok	17/c	Inproduktive	16.50	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	

58	123	EP Kastriot - Sllovë	Vorret e Rekës	18/a	Pyll	16.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
59	124	EP Kastriot - Sllovë	Vorret e Rekës	18/b	Kullotë	24.00	Kullotë	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
60	125	EP Kastriot - Sllovë	Vorret e Rekës	18/c	Inproduktive	2.75	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
61	126	EP Kastriot - Sllovë	Biçaj	19/a	Pyll	15.00	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
62	127	EP Kastriot - Sllovë	Biçaj	19/b	Kullotë	12.00	Kullotë	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
63	128	EP Kastriot - Sllovë	Bituk	1/a	Pyll	4.50	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
64	129	EP Kastriot - Sllovë	Shullan	2/a	Pyll	12.50	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
65	130	EP Kastriot - Sllovë	Përroi i Dullës	3/a	Pyll	11.00	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
66	132	EP Kastriot - Sllovë	Përroi i Dullës	3/c	Pyll	20.50	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
67	133	EP Kastriot - Sllovë	Selez	4/a	Pyll	37.00	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
68	134	EP Kastriot - Sllovë	Livadhi i Stojës	4/b	Pyll	7.00	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
69	135	EP Kastriot - Sllovë	Përroi i Halilit	5/a	Pyll	7.00	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
70	136	EP Kastriot - Sllovë	Tusha e Velishtit	5/b	Pyll	44.00	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
71	137	EP Kastriot - Sllovë	Kodra e Xhipit	6/a	Pyll	8.50	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
72	138	EP Kastriot - Sllovë	Ara Veç	7/a	Pyll	0.75	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
73	139	EP Kastriot - Sllovë	Përroi i Bralicës	8/a	Pyll	12.50	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
74	140	EP Kastriot - Sllovë	Përroi i Bralicës	9/a	Pyll	38.50	Prodhues	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
75	141	EP Kastriot - Sllovë	Sorokol	10	Pyll	46.00	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
76	142	EP Kastriot - Sllovë	Përroi i Rasës	11/a	Pyll	3.25	Mbrojtës	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	
77	143	EP Kastriot - Sllovë	Përroi i Rasës	11/c	Inproduktive	4.50	Inproduktive	M.M.P.A.U.	Kom. Kala e Dodës	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
66 - 130;	Pyje, kullota, të tjera	Në pronësi
132 - 143.	Pyje, kullota, të tjera	Në pronësi

**VENDIM****Nr.699, datë 21.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS LEKAS TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Lekas të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Lekas të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.298, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Lekas të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Lekas për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna: Lekas

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
21-34	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
46,47	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
35-45	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
48-64	Varrezat publike.	Në pronësi
89-101 (Vetëm trojet e lira)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
65-87,89-101(Vetëm sheshet)	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi

1-20	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
390-393,395,396,398,400, 401,403,404,406,408, 410,411	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
394,397,399,402,405, 407,409,412-415	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
102-136	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
153-164	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e pyje-kullotave.	Në pronësi

**VENDIM**  
**Nr.705, datë 21.5.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “CERNALEVE”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (Ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Cernaleve”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Hydroalbania” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Cernaleve”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.706, datë 21.5.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME  
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “LUBONJË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË  
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (Ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Lubonjë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Alb-Agron” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Lubonjë”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.707, datë 21.5.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME  
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “URA E PRENIT”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT,  
NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (Ndërtim, Operim dhe Transferim) të hidrocentralit “Ura e Prenit”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Loshi BL” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Ura e Prenit”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë

oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.708, datë 21.5.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “DARDHË 1”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (Ndërtim, Operim dhe Transferim) të hidrocentralit “Dardhë 1”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Filipi Energy”, sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Dardhë 1”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.709, datë 21.5.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “DUNICË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të

formës “BOT” (Ndërtim, Operim dhe Transferim) të hidrocentralit “Dunicë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Albfrut 2005” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Dunicë”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.710, datë 21.5.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “ORENJË 1” E “ORENJË 2”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (Ndërtim, Operim dhe Transferim) të hidrocentralit “Orenjë 1” e “Orenjë 2” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Gurra” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Orenjë 1” e “Orenjë 2”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.711, datë 21.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR  
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE  
SHOQËRISË “BISTRICA 3” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE  
“BISTRICA 3 E 4”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.1006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (Ndërtim, Operim dhe Transferim) të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Bistrica 3” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Bistrica 3 e 4”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.712, datë 21.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR  
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE  
SHOQËRISË “IRZ” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “SELISHTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (Ndërtim, Operim dhe Transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “IRZ” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Selishtë”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.713, datë 21.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR  
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE  
SHOQËRISË “AURORA KONSTRUKSION” SHPK, PËR NDËRTIMIN E  
HIDROCENTRALIT “VLUSHË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim, Operim dhe Transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Aurora Konstruksion” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Vlushë”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.714, datë 21.5.2008**

**PËR SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË  
DËRGUARA ME MISIONE USHTARAKE JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 6 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes e të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me INSIG, sh.a.-në, të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të dërguar me misione ushtarake jashtë vendit, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2008, të miratuara për këtë ministri.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe INSIG, sh.a.-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**  
**Nr.22, datë 29.5.2008**

**PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË PLANIFIKUARA PËR TRANSPORTIN E MËSUESVE DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË E PUNOJNË LARG VENDBANIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.486, datë 8.4.2008 “Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit të tyre”,

**UDHËZOJ:**

1. Transporti i mësuesve që punojnë larg vendbanimit të tyre në distancë mbi 4 km dhe kthehen brenda ditës, si dhe transporti i nxënësve të arsimit të detyrueshëm që ndjekin shkollën larg vendbanimit të tyre në distancë mbi 2 km, mbulohet nga fondet e Buxhetit të Shtetit të planifikuara për çdo drejtori arsimore rajonale/zyrë arsimore (DAR/ZA).

2. Shpenzimet dhe fondi limit për këtë shërbim prokurohen në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu II “Rregulla të përgjithshme të prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, nga çdo DAR/ZA për vitin kalendarik.

3. Për llogaritjen e fondit limit për këtë shërbim, nga çdo autoritet kontraktor ngrihet grupi i punës, i cili përcakton fondin limit për realizimin e këtij shërbimi, duke u mbështetur në të dhënat e mëposhtme:

- a) numri i mësuesve dhe nxënësve që udhëtojnë;
- b) numri i ditëve mësimore në javë;
- c) numri i javëve mësimore;
- d) çmimi mesatar i biletës ditore (vajtje-ardhje).

4. Për çmimin mesatar të biletës ditore grupi i punës mbështet në të dhënat e mëposhtme:

- a) çmimet mesatare të tregut,
- b) treguesit e botuar nga INSTAT, për indeksimin e çmimeve të shërbimit të transportit;
- c) çmimi mesatar i biletës për linjat interurbane, i miratur nga Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit.

5. Subjekti që merr përsipër kryerjen e këtij shërbimi, likujdohet çdo muaj për punën e kryer, në bazë të faturës tatimore, ku të ketë të përcaktuar numrin e mësuesve dhe të nxënësve që lëvizin çdo muaj.

6. DAR/ZA çdo muaj kërkon nga drejtorët e shkollave paraqitjen e vërtetimit për numrin e mësuesve dhe të nxënësve që lëvizin sipas linjave.

7. Në fund të çdo muaji, përpara pagimit të shërbimit, drejtori i DAR/ZA, përgjegjësi i burimeve njerëzore dhe specialisti i financës përpilojnë një aktrakordim, mbi numrin e mësuesve dhe të nxënësve, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga drejtoritë e shkollave dhe faturës së lëshuar nga subjekti që merr përsipër kryerjen e këtij shërbimi.

8. DAR/ZA në fillim të çdo viti kalendarik, përcaktojnë hartën e linjave dhe e miratojnë atë në këshillin e qarkut. Vendimi i këshillit të qarkut përmban distancën e linjave dhe kategorinë e rrugëve.

9. Për rastet e pamundësisë së zhvillimit të procedurës së prokurimit për ndonjë linjë të veçantë, pasi të jetë kryer e gjithë procedura e prokurimit, sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, DAR/ZA kryen pagesat për mësuesit dhe nxënësit, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga drejtorët e shkollave për numrin e mësuesve dhe të nxënësve që lëvizin sipas linjave. DAR/ZA harton listëpagesat për mësuesit dhe nxënësit dhe kalon pagesën për mësuesit në numrin e llogarisë bankare dhe për nxënësit pranë zyrave të postës shqiptare.

10. Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë DAR/ZA, në periudhën e planifikimit të numrit të mësuesve, në fillim të vitit shkollor kanë përgjegjësi për rritjen artificiale të lëvizjes së mësuesve, nga një njësi vendore në tjetrën.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Planifikimit Buxhetor, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Genc Pollo

**VENDIM**  
**Nr.57, datë 2.6.2008**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC I TERVOLIT” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “a” dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.6.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC i Tervolit” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit, shfrytëzimit, si dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC i Tervolit dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit të përcaktuar në rregulloren e procedurave të licencimit, dhe se shoqëria është mbajtëse e një marrëveshjeje koncesioni me një afat 30-vjeçar për këtë hidrocentral,

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “HEC i Tervolit” sh.p.k., në aktivitetin e ndërtimit, instalimit, shfrytëzimit, si dhe prodhimit të energjisë elektrike nga HEC i Tervolit për një kohëzgjatje prej 30 vjetësh.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S  
Bujar Nepravishta

**VENDIM**  
**Nr.58, datë 3.6.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**  
**NR.9, DATË 25.1.2008 “PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E**  
**FURNIZIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË OSSH SHA”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “ç” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë, elektrike”, të ndryshuar, pikës 2, paragrafi 12, të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.6.2008, mbasi shqyrtoi propozimin për ndryshimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 25.1.2008 “Për dhënien e licencës për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike shoqërisë OSSH sh.a.”

dhe konstatoi se:

- Modeli i tregut të energjisë elektrike parashikon si pjesëtar të tregut të energjisë elektrike furnizuesin publik me pakicë, i cili do të funksionojë si një njësi e OSSH sh.a. e ndarë funksionalisht dhe financiarisht,
- OSSH sh.a. është mbajtëse e licencës për furnizimin me energji elektrike të klientëve tariforë,

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.9, datë 25.1.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për dhënien e licencës për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike shoqërisë OSSH sh.a.” në pikën 1, pas fjalës furnizimit shtohen fjalët:

– publik me pakicë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ta njoftojë shoqërinë OSSH sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.59, datë 30.6.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**  
**NR.11, DATË 23.6.2006 “PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR AKTIVITETIN E**  
**PRODHIMIT, SHPËRNDARJES, FURNIZIMIT, IMPORTIT DHE EKSPORTIT TË**  
**ENERJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË KESH SHA”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “ç” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 2, paragrafi 9, të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.6.2008, mbasi shqyrtoi propozimin për ndryshimin e vendimit të Bordit të

Komisionerëve nr.11, datë 23.6.2006 “Për dhënien e licencave për aktivitetin e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, importit dhe eksportit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.” dhe konstatoi se:

- Modeli i tregut të energjisë elektrike parashikon si pjesëtar të tregut të energjisë elektrike furnizuesin publik me shumicë, i cili do të funksionojë si një njësi e KESH sh.a. e ndarë funksionalisht dhe financiarisht,

- KESH sh.a. ka aplikuar për përcaktimin e tarifës së furnizuesit publik me shumicë për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2008,

ERE përcakton tarifat e energjisë për aktivitet e licencuara,

#### VENDOSI:

1. Në vendimin nr.11, datë 23.6.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për dhënien e licencave për aktivitetin e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, importit dhe eksportit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.” në pikën I, shtohet pika 6 me përmbajtjen:

6 – aktivitetin e furnizimit publik me shumicë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë KESH sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 17.6.2008  
Doli nga shtypi më 17.6.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”  
Tiranë, 2008